



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më __.11.2023

MBLEDHJA Nr. 59,
Datë 22.11.2023, ora 10:30
e Bordit të ERE-s

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Mërkurë, datë 22.11.2023, ora 10:30**, do të zhvillohet mbledhja nr. 59 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbal-ve të mbledhjeve të bordit të ERE-s më datë 06.11.2023 dhe datë 14.11.2023.
2. Mbi kërkesën e shoqërisë “Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (Sh.A KESH)” për dhënien e Garancisë së Origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga HEC “Fierzë”, HEC “Koman” dhe HEC “Vau i Dejës”
3. Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 228, datë 17.07.2023, “Mbi përcaktimin e shoqërisë “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike ALPEX” sh.a., si operatori i emëruar i tregut të energjisë elektrike (NEMO)”
4. Mbi kërkesën e shoqërisë “GEALB ENERGY” shpk, për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hidrocentralet “Guri i Bardhë 1” dhe “Guri i Bardhë 2”
5. Mbi shfuqizimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 133, datë 06.06.2022, “Mbi kërkesën e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes, miratuar me vendimin nr. 166, datë 10.10.2016, të Bordit të ERE, e ndryshuar”
6. Çështje të tjera

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI